

PRANUAR MË

ACCEPTED ON

PRILM JENQ

On the day

14/09/2023

22/441



REPUBLIKA EKOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

STATUTI

I

KOMUNËS SË MALISHEVËS

Malishevë, 2023

Duke rikujtuar të kaluarën historike kombëtare, qëndresa shekullore e pandërprerë e popullit shqiptar për liri dhe pavarësi, bëri qël në fund lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila me luftën e saj heroike dhe me ndihmën vendimtare të NATO-së, i dha fund robërisë nga ish Jugosllavia, gjegjësisht Serbia. Si rezultat i saj u fitua edhe liria, që solli Pavarësinë e Kosovës.

Në bazë të nenit 123 dhe 124 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të fuqizuar më 15 qershor 2008, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika (a) dhe 12.3 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me dt._____, miratoi:

STATUTIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 PËRKUFIZIMI

Statuti i Komunës, është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me nenin 12 pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Statuti rregullon organizimin e brendshëm të Komunës. Nëpërdorimin e mëtutjeshëm do të njihet si “Statuti i Komunës së Malishevës”.

Neni 2 STATUSI JURIDIK

- 2.1 Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet tjera në fuqi që e rregullon këtë lëmi.
- 2.2 Komuna e ka statusin e personit juridik.
- 2.3 Ajo e ka të drejtën të jetë titullare e së drejtës pronësore, të posedojë dhe të administrojë pasurinë,
- 2.4 Ka të drejtë për të ushtruar padi dhe për të qenë e paditur në gjykatën kompetente,
- 2.5 Të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të ofruar shërbime
- 2.6 Të drejtën që të punësojë punëtorë (staf) në punë.

Neni 3
ADRESA E KOMUNËS

Selia e Komunës së Malishevës gjendet në rrugën “Skënderbeu“ në Malishevë.

Neni 4
PËRGJEGJËSITË E KOMUNËS

- 4.1 Përgjegjësitë e Komunës ushtrohen, organizohen dhe menaxhohen në pajtueshmëri të plotë me ligjet, të cilat rregullojnë përgjegjësitë e Komunës, në pajtueshmëri me Statutin e Komunës, si dhe rregulloren e punës të miratuar nga Kuvendi i Komunës.
- 4.2 Statuti i Komunës së Malishevës, parasheh sigurimin e zbatimit të përgjegjësisë të Komunës, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës(Ligji nr.03/L-040) që në tekstin e mëtejme do të njihet si Ligji për Vetëqeverisjen Lokale.
- 4.3 Statuti i Komunës zbatohet vetëm brenda kufijve të Komunës së Malishevës. Ai rregullon kompetencat dhe pushtetin e Komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në mbledhje, aktivitet e saj dhe transparencën rreth mënyrës së vendosjes në punët publike.
- 4.4 Ky statut do t’i përcaktojë edhe organet e Komunës, shërbimin civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, administrimin financiar, konfliktin e interesave, aktin formal, dokumentet zyrtare dhe informatat përpunën e Kuvendit të Komunës.
- 4.5 Komuna e Malishevës (në tekstin e mëtejme Komuna), ka emblemën e vet, ku përmbajtja dhe përdorimi i saj është i përcaktuar me vendim të Komunës.
- 4.6 Asnjë person fizik apo juridik, përveç Komunës nuk ka të drejtë të përdorë emblemën ose simbolet e tjera të Komunës pa autorizim paraprak të shkruar nga organet kompetente.

Neni 5
KUFIJTË ADMINISTRATIV

- 5.1 Komuna e Malishevës i ka kufijtë dhe territorin e vet, në një sipërfaqe prej 306 km², ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave (Ligji- nr.03/L-041), ndërsa si njësi territoriale e përbëjnë :
1. Malisheva si qendër komunale së bashku me lagjet urbane:
 1. Lagjja “Guri”
 2. Lagjja “Matoshi`
 3. Lagjja “Hoti”
 4. Lagjja “Veselaj”
 5. Lagjja “Hysenaj”
 6. Lagjja “Mirëdita”
 7. Lagjja “Goleshi”
 8. Lagjja “Mekaj”

5.2 Fshatrat e Komunës së Malishevës janë:

1. Astrazup	23. Llazicë
2. Balincë	24. Llapçevë
3. Banjë	25. Lladroviq
4. Berishë	26. Maxharrë
5. Bellanicë	27. Marali
6. Bubavec	28. Mirushë
7. Bubël	29. Mleqan
8. Joviq	30. Ngucat
9. Carallukë	31. Pagarushë
10. Damanek	32. Panorc
11. Llashkadrenoc	33. Pllaqicë
12. Dragobil	34. Qypevë
13. Fshati i Ri	35. Rudë
14. Carravranë	36. Senik
15. Gajrak	37. Shkozë
16. Guriq	38. Shkarashnik
17. Golluboc	39. Temeqinë
18. Janqishtë	40. Tërpezë
19. Kijevë	41. Tërpezë e Poshtme
20. Kërvasari	42. Turjakë
21. Lubizhdë	43. Vërmicë
22. Lladroc	

Neni 6

BASHKËSITË LOKALE

6.1 Sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019 dhe vendimit të Kuvendit, fshatrat e Komunës së Malishevës janë të organizuara në këto bashkësi lokale:

Në territorin e Komunës së Malishevës, formohen këto këshilla lokale si më poshtë:

1. Këshilli lokal i lagjeve urbane: Malisheva 1 (Lagjet Gurit, Veselaj, Mirëdita, Goleshi),
2. Këshilli lokal i lagjeve urbane: Malisheva 2 (Lagjet Hoti, Hysenaj, Matoshi, Mekaj),
3. Këshilli lokal i fshatrave: Damanek, Bubël, Qypevë,
4. Këshilli lokal i fshatrave: Mleqan, Pllaqicë, Golluboc,
5. Këshilli lokal i fshatrave: Astrazup, Joviq,
6. Këshilli lokal i fshatrave: Shkozë, Janqishtë,
7. Këshilli lokal i fshatrave: Dragobil, Maxharrë,
8. Këshilli lokal i fshatrave: Pagarushë, Guriq,
9. Këshilli lokal i fshatrave: Ngucat, Temeqinë,
10. Këshilli lokal i fshatrave: Marali, Gajrak,

11. Këshilli lokal i fshatrave: Banjë, Kërvasari,
12. Këshilli lokal i fshatrave: Bellanicë, Lladroviq,
13. Këshilli lokal i fshatrave: Lladroc, Senik,
14. Këshilli lokal i fshatrave: Carravranë, Mirushë,
15. Këshilli lokal i fshatrave: Kijevë, Bubavec,
16. Këshilli lokal i fshatrave: Panorc, Rudë, Llapçevë,
17. Këshilli lokal i fshatrave: Llashkadrenoc, Vërmicë,
18. Këshilli lokal i fshatrave: Llazicë, Balincë,
19. Këshilli lokal i fshatrave: Carallukë, Shkarashnik,
20. Këshilli lokal i fshatrave: Tërpezë, Tërpezë e Poshtme,
21. Këshilli lokal i fshatrave: Berishë, Fshat i Ri,
22. Këshilli lokal i fshatrave: Turjakë, Lubizhdë

Neni 8

BASHKËPUNIMI NËDRKOMUNAL DHE ARANZHIMET BRENDAKOMUNALE

- 7.1 Brenda territorit të saj, Komuna ushtron përgjegjësitë, të cilat nuk i janë rezervuar shprehimisht me ligj pushtetit qendror. Komuna mund të delegojë përgjegjësitë e saj te komunat tjera apo të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera, në pajtueshmëri me ligjin në fuqi.
- 7.2 Në pajtim me ligjin në fuqi që rregullon këtë lëmi, Komuna mund të delegojë aktivitete në lidhje me shërbimet komunale në vendbanime urbane dhe fshatra, si dhe te personat fizikë dhe juridikë.
- 7.3 Komiteti për Politikë dhe Financa, i shqyrton dhe i propozon Kuvendit të Komunës një numër të caktuar të funksioneve, që nuk bien ndesh me ligjin për ushtrimin e këtyre përgjegjësisë nga përfaqësuesit e personave të cekur që kryejnë shërbime në emër të Komunës në lagje urbane dhe fshatra.
- 7.4 Kuvendi i Komunës për çdo vit do ta mbikëqyrë realizimin e këtyre përgjegjësisë të përbashkëta dhe në çdo moment mund t'i marrë ato përgjegjësi, kur konstaton se nuk zbatohen në pajtim me ligjin.
- 7.5 Të gjitha këto marrëveshje nuk mund të kenë mandat më të gjatë se vetë mandati i Kuvendit të Komunës.
- 7.6 Marrëveshjet duhet të mbulojnë, mes tjerash:
 - a. fondin e siguruar
 - b. të ardhurat
 - c. shërbimet
- 7.7 Për shtrirjen edhe më tej të përgjegjësisë të përcaktuara me ligj, Komuna mund të krijojë zyrë komunale informuese apo shërbyese për të ofruar shërbime më pranë qytetarëve të saj.
- 7.8 Komuna mban kontrollin e plotë të secilës fushë të kompetencës së saj të dekoncentruar.

Neni 8

EMBLEMA (STEMA), FLAMURI DHE VULAT E KOMUNËS SË MALISHEVËS

- 8.1 Kuvendi i Komunës së Malishevës e ka emblemën (stemën), flamurin dhe vulën e vet, me të cilat identifikohet.
- 8.2 Komuna së Malishevës e ka emblemën (stemën) dhe flamurin e vet, me të cilat identifikohet.
- 8.3 Simbolet e Komunës përdoren brenda territorit të saj në pajtimin me Ligjin për simbolet shtetërore (vendos numrin e ligjit)

8.4 Komuna e Malishevës e ka vulën e vet të rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit, si dhe vulën për vërtetimin edokumenteve nga origjinali.

8.5 Komuna e ka emblemën e vet. Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës do të përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës. Emblema është e vendosur në vulat e Komunës.

8.6 Vula e rrumbullakët përmban tekstin:

- a. Rrethi i parë: Republika e Kosovës
- b. Rrethi i dytë: Komuna e Malishevës,
- c. Rrethi i tretë: Emërtimi i organit përgjegjës sipas ligjit.
- d. Në mes të vulës është emblema e Komunës së Malishevës.

8.7 Vula e protokollit të Komunës së Malishevës ka formën e katërkëndëshit kënddrejtë, me këtë tekst:

- a. Rendi i parë: Republika e Kosovës
- b. Rendi i dytë: Komuna e Malishevës
- c. Rendi i tretë: Numri i protokollit të organit dhe data e pranimit apo lëshimit, të cilat duhet të përshkruhen me dy vija të drejta paralele, ku në fillim të vijës shkruan për datën dhe në të dytën për numrin e protokollit.

8.8 Asnjë subjekt dhe person tjetër fizik apo juridik, përveç Komunës, nuk mund ta përdorë vulën, përveç personit zyrtar, i cili ka autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente të Komunës.

8.9 Vula e Kuvendit Komunal dhe e Komunës miratohet apo ndryshohet nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 9 FESTAT PUBLIKE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

9.1 Komuna e Malishevës e ka ditën e festës së saj publike, e cila festohet në ditën e cila ndërlidhet me:

- a. 16 Qershorin, “Ditën e Çlirimit të Malishevës”
- b. Ditën e rënies së dëshmorit të parë dhe rënies së dëshmorit të fundit, që ndërlidhet me datën 16 Qershor.

9.2 Shënimin e kësaj dite e organizon Kuvendi i Komunës së Malishevës.

9.3 Për nder të Ditës së Çlirimit dhe të Dëshmorëve, Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë përcakton kushtet dhe mënyrën e ndarjes së dhuratave, shpërblimeve, dekoratave, mirënjohjeve dhe titujve në të gjitha fushat me çmimet:

- a. Çmimi “Imer Krasniqi” - për trimëri dhe heroizëm;
- b. Çmimi “Hamdi Berisha” për kontributin e dhënë në shkollën shqipe;
- c. Çmimi “Dr. Shpëtim Robaj” për kontribut në fushën e mjekësisë.

9.4 Me propozim të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë jep (ndan) dhurata në kundërvlerë monetare në monedhën € (euro).

Neni 10 DITËT PËRKUJTIMORE

10.1 Masakra e Burimit, 31 Mars

- 10.2 Masakra e Gullubocit, 26 Shtator
- 10.3 Masakra e Llapçevës, 5 Prill
- 10.4 Masakra e Senikut e ndodhur më 28 Gusht
- 10.5 Përkujtimi për Maturantët e Gjimnazit “Abdyl Frashëri” më 14 Tetor

Neni 11 MIRËNJOHJET

- 11.1 Qytetar nderi
- 11.2 Për të arriturat në fusha specifike (të veçanta)

Neni 12 GJUHËT

Përdorimi i gjuhëve në komunë, rregullohet në pajtim me Ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve.

Neni 13 PËRGJEGJËSITË DHE PUSHTETI I KOMUNËS

- 13.1 Komuna e Malishevës brenda territorit të vet në pajtim me Ligjin, është përgjegjëse për:
 - a. ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
 - b. planifikimin urban të qytetit të Malishevës, fshatrave dhe shfrytëzimin e tokës;
 - c. lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime tjera;
 - d. mbrojtjen lokale të ambientit;
 - e. zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollin e standardeve të ndërtimit;
 - f. ofrimin e shërbimeve lokale dhe të infrastrukturës, duke përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe transportin lokal;
 - g. shërbimet publike, duke përfshirë shërbimet e zjarfikësve dhe emergjencës;
 - h. udhëheqjen e pronës së Komunës;
 - i. edukimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
 - j. kujdesin parësor shëndetësor;
 - k. shërbimet sociale dhe strehimin;
 - l. mbrojtjen e konsumatorëve dhe të shëndetit publik;
 - m. lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin publik lokal dhe shërbimet e taksive, gjuetinë dhe peshkimin, restorantet dhe hotelet, etj;
 - n. panairët dhe tregjet;
 - o. sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve, hapësirave publike dhe varrezave të dëshmorëve, martirëve, përmendoreve dhe monumenteve tjera të rëndësishme historike;
 - p. përkujdesjen dhe strehimin për të moshuarit;
 - q. promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
 - r. aktivitetet tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për administrimin adekuat të territorit të Komunës që nuk janë të përcaktuara me ligj, rregullore apo akte tjera nënligjore, që rregullojnë këtë lëmi.
- 13.2 Përveç aktiviteteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Komuna mund të marrë edhe veprime tjera brenda territorit të saj dhe rreth çështjeve me interes për Komunën, por që do të jenë çdo herë në pajtim me Ligjin.

13.3 Këtu mundë të përfshihen edhe aktivitetet vijuese:

- a. turizmi;
- b. aktivitetet kulturore;
- c. sporti dhe aktivitetet e lira;
- d. aktivitetet e rinisë;
- e. avancimi i rinisë;
- f. avancimi i vlerave qytetare.

13.4 Komuna do të sigurojë që të gjithë qytetarët pa dallim, të deklarojnë lirshëm identitetin etnik, kulturor dhe fetar, njëherit brenda kompetencave të saj ju garanton këto liri, pa asnjë dallim.

13.5 Komuna është, gjithashtu, përgjegjëse edhe për zbatimin e ligjeve në fuqi, me të cilat obligohet, si: regjistrat kadastralë, regjistrat civilë, regjistrimin e votuesve dhe regjistrimin e bizneseve. Për realizimin e këtyre përgjegjësi, Komunës do t'i sigurohen burime financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

13.6 Institucionet e Republikës së Kosovës, mund t'i delegojnë Komunës përgjegjësi shtesë, që janë në kuadër të kompetencave të tyre, me kusht që Komunës t'i sigurohen edhe mjetet financiare.

13.7 Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, mund të marrë veprime parandaluese ndaj Komunës, nëse veprimet e marra nga Komuna nuk janë në pajtim me Ligjin në fuqi.

Neni 14

PJESËMARRJA E DREJTPËRDREJTË E QYTETARËVE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS NË VETËQEVERISJEN LOKALE

14.1 Qytetarët e Komunës së Malishevës, mund të marrin pjesë në qeverisjen e Komunës, t'i propozojnë asaj tema të ndryshme për diskutim, si dhe mund të marrin pjesë në marrjen e vendimeve.

14.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në shqyrtimin e çështjeve që janë në interes publik, mund të bëhet përmes:

- a. mekanizmeve të paraparë ligjorë përmes konsultimeve,
- b. pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në tubime që kanë karakter vendimmarrës.

14.3 Me qëllim të përmbushjes së të drejtave dhe obligimeve ligjore, për kategori të caktuara të qytetarëve, Komuna do të organizojë:

- c. fushata informative për promovimin e programeve dhe të aktiviteteve të Komunës;
- d. kontaktet me grupe të ndryshme të interesit;
- e. anketat që kanë për qëllim studimi ndikimin e politikave të ndryshme që i zbaton Komuna;
- f. shpallja publike e propozimeve që pretendon Komuna për realizimin në të ardhmen,
- g. tubimet si dhe seancat publike;
- h. studimin e ndikimeve të politikave qeverisëse të Komunës te qytetarët;
- i. gjithashtu Komuna do t'i marrë për bazë edhe komitetet këshillëdhënëse që do të formohen nga qytetarët;
- j. si dhe organizimin e referendumit lokal për çështjet që dalin nga përgjegjësitë e Komunës.

14.4 Komuna do të krijojë mekanizma me qëllim të ofrimit të mundësive sa më të favorshme për pjesëmarrjen e publikut, si dhe do të krijojë një afat të arsyeshëm ligjor për të pasur kohë të mjaftueshme për t'i prezantuar qëllimet e qytetarëve apo grupeve të caktuara të interesit.

14.5 Të gjitha prezantimet e arsyeshme të qytetarëve, apo të grupeve të ndryshme të interesit do të merren për shqyrtim dhe ato do të publikohen për njoftim publik, për të kuptuar masa, si dhe do të njoftohen qytetarët për vendimin që do ta marrë Komuna në lidhje me këtë çështje.

14.6 Të gjitha mbledhjet e organeve të Komunës, përveç atyre të parapara me ligj, të cilat nuk duhet të

jenë të hapura për publikun, janë të hapura për qytetarët, mediat si dhe për grupet e interesuara të qytetarëve.

14.7 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës dhe Komitetet e Kuvendit, duhet të kenë autoritetin të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që është kompetencë e tyre.

14.8 Komuna duhet të lejojë kohë të mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve dhe kontributeve me shkrim. Komuna duhet t'i lejojë së paku 8 javë afat për marrjen e përgjigjeve me shkrim për konsultimin me publikun, ndërsa standardi duhet të jetë 12 javë.

Neni 15

MIRATIMI I RREGULLOREVE KOMUNALE

15.1 Para miratimit të çdo rregulloreje, Komuna do të praktikojë një formë të gjerë të konsultimeve paraprake dhe atënjë mënyrë publike, duke e informuar qytetarin e interesuar për të gjitha detajet e aktit në fjalë dhe atë përmes formave:

- a. Fushatës informative;
- b. Shpalljeve publike;
- c. Debateve të ndryshme me OJQ, qytetarë, biznese, e të tjera, si dhe
- d. Studimit dhe vlerësimit të ndikimit të aktit te qytetarët.

15.2 Komuna do të lërë në dispozicion 14 ditë për të dhënë vërejtjet e veta qytetarët, si dhe grupet e ndryshme të interesit.

15.3 Kryetari mund të iniciojë ndryshimin apo hartimin e një Rregulloreje për nevoja të Kuvendit të Komunës, për të cilën gjë e cakton një grup profesional.

15.4 Hartimi i përpiluar për ndryshim dhe plotësim apo hartimi për herë të parë i një akti që rregullon një fushë të caktuar të detyrave të Komunës brenda kompetencave të saj pas hartimit i jepet Kryetarit të Komunës, pastaj Komitetit për Politikë dhe Financa, i cili duhet t'ia rekomandojë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

15.5 Kërkesën për miratimin e një projekt-rregulloreje mund ta parashtrojnë me shkrim së paku 10 anëtarë të Kuvendit, të cilët duhet t'i adresohen kryesuesit të Kuvendit për ta përfshirë si pikë të veçantë të rendit të ditës në mbledhjen e ardhshme. Procedura për projekt-rregullore është e njëjtë me procedurën e paraparë me nen 12.2, të këtij neni, si dhe me procedurat për miratimin e statutit, ndërsa miratimi bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

15.6 Kuvendi i Komunës, gjithashtu, duhet të miratojë edhe Rregulloren e punës dhe mund ta ndryshojë atë nëse konstaton se një gjë e tillë është e nevojshme.

15.7 Rregullorja e punës duhet të sigurojë që të ketë një udhëheqje dhe kontroll, duke përfshirë kontrollin efikas financiar dhe të Administratës së Komunës. Vendimi për miratimin e Rregullores së punësmiratohet me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.

Neni 16

PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS

16.1 Iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës mund të ndërmerret nga:

- a) Kryetari i Komunës,
- b) Një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës,
- c) Me iniciativën e 15% të qytetarëve me të drejtë vote të Komunës së Malishevës.

16.2 Propozimi për ndryshimin e Statutit Komunës duhet të dërgohet në Komitetin për Politikë dhe Financa për shqyrtim dhe pastaj ky organ do t'i rekomandojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim preliminar. Kuvendi i Komunës, para shqyrtimit final, duhet të konsultohet me publikun në lidhje me atë propozim. Çdo propozim për ndryshimin e Statutit të Komunës duhet të miratohet në pajtim me nenin 12 paragrafi 12.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

- a. Pas përfundimit të periudhës së konsultimit, Kuvendi i Komunës duhet të vendosë se a do ta miratojë Statutin mendryshime, pas shqyrtimeve të të gjitha vërejtjeve të marra.
- b) Statuti i Komunës miratohet nëse për të votojnë 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 17

TUBIMET PUBLIKE TË KOMUNËS ME QYTETARË

- 17.1 Në pajtim me ligjin në fuqi që e rregullon vetëqeverisjen lokale, Komuna do të organizojë edhe tubime publike me qytetarë, së paku dy herë në vit, për të realizuar format e vetëqeverisjes lokale.
- 17.2 Në këto tubime Komuna i njofton qytetarët në lidhje me realizimin e politikave të zhvillimit ekonomik, përshqyrtimin e çështjeve që prekin interesin e përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës në Komunë.
- 17.3 Tubimet janë të hapura për publikun dhe mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit,
- 17.4 Pjesëmarrësit në këto takime mund të marrin iniciativa, të bëjnë propozime, si dhe të japin mendime profesionale në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të caktuara.
- 17.5 Mbledhjet duhet të mbahen brenda vitit kalendarik, ndërsa mbledhja e parë do të duhet të mbahet në 6-mujorin eparë të vitit ndërsa mbledhja e dytë do të duhet të mbahet në 6-mujorin e dytë të po atij viti.
- 17.6 Intervali kohor brenda këtyre dy mbledhjeve do të duhet të ishte së paku 3 muaj.
- 17.7 Tubimet do të mund të organizohen edhe nëpër fshatra.
- 17.8 Komuna do të përkujdeset që të gjithë qytetarët të kenë informata të mjaftueshme lidhur me mbledhjet publike, të cilat do t'i organizojë duke paracaktuar, vendin e mbajtjes së mbledhjes, kohën e mbajtjes, e cila duhet të thirret dy javë para se ajo të mbahet, si dhe rendin e ditës së mbledhjes.
- 17.9 Këtë Komuna duhet ta bëjë duke njoftuar qytetarët përmes mjeteve të informimit, shpalljes në tabelën e shpalljes dhe shpalljes dhe vendosjen e tyre në të gjitha vendet e frekuentuara në mënyrë që të kenë qasje të gjithë qytetarët pa dallim.
- 17.10 Tubimet publike i udhëheq Kryetari i Komunës ose përfaqësuesi i tij siç parashihet me ligj.
- 17.11 Kryetari i Komunës ka të drejtën që të përcaktojë rendin e ditës, si dhe kushtet për udhëheqjen e diskutimeve.
- 17.12 Ai ka të drejtë që në çdo kohë të ndërpresë diskutimet, nëse çështjet që përmenden janë jashtë kompetencave të Komunës. Ai ka të drejtë t'i refuzojë në dhënien e fjalës diskutuesve që prezantojnë ose përsërisin pikëpamjet që nuk janë në përputhje me ligjin në fuqi.
- 17.13 Nëse shtrohet ndonjë pyetje që nuk mund të marrë përgjigjen nga kryesuesi i mbledhjes, ai është i obliguar që parashtruesit t'i kthejë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së takimit publik.
- 17.14 Për çdo tubim publik mbahet procesverbal, i cili përmban të gjitha informatat që janë dhënë nga përfaqësuesit komunalë, propozimet e parashtruara nga qytetarët, përgjigjet në lidhje me to, si dhe të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e tyre.
- 17.15 Procesverbalin me të gjitha pjesët e përmendura më lartë, në afat prej 30 ditësh nga dita e mbajtjes

së tubimit publik, e shqyrton Komitetit për Politikë dhe Financa, që e analizon çdo propozim të parashtruar në tubim dhe bën rekomandimet e nevojshme, të cilat njëherësh ia propozon Kuvendit të Komunës për vendosje.

Neni 18 ZGJEDHJET E KËSHILLAVE LOKALE

18.1 Kuvendi i Komunës, me propozimin e Kryetarit ose 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, ka të drejtë të propozojë datën e zgjedhjeve të këshillave lokale, kurse mandatin e kryetarit dhe këshillave lokale e cakton Kuvendi me vendim të veçantë.

18.2 Kuvendi, njëkohësisht do të formojë një komision për implementimin e vendimit për organizimin e zgjedhjeve

18.3 Për përbërjen, numrin e anëtarëve të komisionit, financimin dhe formën e zgjedhjes do të vendosë Kuvendi me vendimin e marrë me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.

Neni 19 PETICIONET

19.1 Secili qytetar, person juridik që ka interes në Komunë, ka të drejtë që me vetiniciativë, përmes formës së Peticionit t'i propozojë Kuvendit Komunës nxjerrjen e akteve juridike, me të cilat do të zgjidheshin çështje të caktuara të rëndësishme për vendbanimin ku jeton.

19.2 Subjektet e përmendura më lart, mund t'i drejtojnë peticion Kuvendit të Komunës, për çështjet që janë në kompetencën e saj, mënyrë të pakufizuar e që kanë të bëjnë me:

- a. Mirëmbajtjen e pastërtisë së vendbanimit
- b. Mirëmbajtjen e infrastrukturës së vendbanimit
- c. Çështjet që kanë të bëjnë me urbanizmin
- d. Mirëmbajtjen e ambientit
- e. Implementimin e ligjit
- f. Çështjet tjera të rëndësishme për komunitetin në përgjithësi.

19.3 Iniciativa për përpilimin e peticionit fillon, me nënshkrimin e tyre në formë të peticionit me propozim të veçantë të çështjeve që kërkohen me peticion, i njëjti i drejtohet Kuvendit të Komunës përmes Udhëheqësit të Administratës dhe Personelit.

19.4 Peticioni e ka plotfuqishmërinë e vet juridike kur ai (peticioni) i plotëson kriteret e cekura, si dhe kur atë ta kenë nënshkruar 500 qytetarë, me të drejtë vote dhe që janë të regjistruar në listën e votuesve të Komunës Malishevës.

19.5 Për çështje, të cilat kërkojnë të vendosen e që kanë të bëjnë me fshatin, peticioni do të jetë i plotfuqishëm dhe duhet të shqyrtohet edhe kur atë ta kenë nënshkruar gjithsej 15 % të votuesve me të drejtë vote të lokalitetit përkatës.

19.6 Çdo peticion për të qenë i plotfuqishëm duhet të ketë :

19.7 Emrin dhe mbiemrin, adresën e parashtruesit/ve.

19.8 Lëndën konkrete të peticionit që kërkohet të shqyrtohet.

19.9 Emrin e organit që ka të bëjë me çështjen konkrete.

19.10 Komunitetet mund të parashtrojnë peticion përmes Komitetit të komuniteteve.

19.11 Një peticion, i cili nuk përmban elementet e cekura më lart, nuk do të konsiderohet si i tillë.

19.12 Udhëheqësi i Administratës dhe Personelit, në afatin e paraparë ligjor prej 30 ditësh, çdo petition të vlefshëm, ia prezanton Kryetarit dhe i njëjti ia prezanton Kryesuesit në mënyrë që ai ta prezantojë para Kuvendit të Komunës për shqyrtim. Kuvendi mund ta shqyrtojë çështjen në fjalë, si dhe mund t'i bartë për vendosje Komitetit për Politikë dhe Financa.

19.13 Parashtruesi/it apo personi i caktuar në emër të tij, mund të merr fjalën për të dhënë sqarime plotësuese që kishin Për ta lehtësuar punën e Kuvendit.

19.14 Vendimin në lidhje me petitionin duhet ta marrë Kuvendi i Komunës apo organi kompetent që e ka caktuar Kuvendi, dhe atë në afat prej 2 muajsh, ndërsa nëse është çështje që kërkon marrjen e masave sa më të shpejta edhe brenda afatit prej 1 muajsh. Për rëndësinë dhe formën e shqyrtimit do të vendosë Kuvendi me shumicë votash.

19.15 Vendimi duhet të merret me shkrim dhe i njëjti duhet të arsyetohet dhe t'i prezantohet parashtruesit/ve.

Neni 20 INICIATIVAT E QYTETARËVE

20.1 Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve në pëlqim me ligjin në fuqi.

20.2 Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

20.3 Draft-rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës.

20.4 Kuvendi i Komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimi.

Neni 21 REFERENDUMI

21.1 Qytetarët e Komunës së Malishevës mund të kërkojnë që Rregullorja e Kuvendit të Komunës e miratuar nga Kuvendi i Komunës, t'i nënshtrohet referendumi.

21.2 Kërkesa duhet t'i dorëzohet kryesuesit të Kuvendit të Komunës, brenda afatit 30 ditësh nga data e miratimit të Rregullores e cila duhet të nënshkruhet nga 10% e votuesve të regjistruar në regjistrat votues të Komunës së Malishevës.

21.3 Kuvendi i Komunës duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 30 ditësh pas pranimi të petitionit, në pajtim me ligjin.

Neni 22 KOMITETET KONSULTATIVE

- 22.1 Kuvendi i Komunës mund të krijojë komitetet konsultative sektoriale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.
- 22.2 Komitetet Konsultative, gjithashtu, mund të bëjnë propozime për përmirësimin apo zgjidhjen e problemeve të identifikuar.
- 22.3 Në kryerjen e detyrave të tyre, Komitetet konsultative duhet të punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në mënyrë të tillë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit apo të Kuvendit të Komunës duhet të merren vetëm paskonsultimit me Komitetin konsultativ sektorial.
- 22.4 Anëtarët e Komiteteve konsultative duhet të emërohen me mandat 3-vjeçar në baza të rregullta, ku 1/3 e anëtarëve duhet të emërohet çdo vit. Asnjë anëtar i Komitetit konsultativ nuk mund të shërbejë më shumë se në dy mandate të njëpasnjëshme.

Neni 23 ORGANET E KOMUNËS

23.1 Organet e Komunës janë:

- a) Kuvendi i Komunës, është organi më i lartë i Komunës,
- b) Kryetari i Komunës, është organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

23.2 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë, i cili i ushtron të gjitha përgjegjësit e veta në përputhje me ligjin, statutin dhe akteve tjera nënligjore në fuqi.

23.3 Kuvendi i Komunës së Malishevës i ka gjithsej 31 këshilltarë.

23.4 Përgjegjësitë dhe pushteti i Komunës duhet të ushtrohen nga Kuvendi dhe Kryetari i Komunës, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.

23.5 Kuvendi zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu siç është e paraparë me Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Kosovë.

23.6 Të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës kanë të drejta dhe obligime të barabarta, si dhe mundësi të barabarta në pjesëmarrjen e të gjitha punëve të Kuvendit.

23.7 Kuvendi i Komunës nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë në lidhje me marrjen e vendimeve, sa i përket;

- a. Miratimit /ndryshimit dhe shfuqizimit të Statutit,
- b. Miratimit të buxhetit,
- c. Miratimit të çështjeve tjera financiare, që sipas ligjit i janë rezervuar vetëm Kuvendit të Komunës,
- d. Kompensimit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës,
- e. Raportit vjetor,
- f. Miratimit, ndryshimit dhe anulimit të rregulloreve komunale
- g. Themelimit të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera të domosdoshme sipas ligjit në fuqi, zgjedhjes së kryesuesit,
- h. Lartësisë së tarifave, gjobave dhe ngarkesave komunale,
- i. Krijimit dhe përdorimit të simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit,
- j. Emërimit dhe riemërimit të rrugëve shesheve dhe vendeve tjera publike, bërjes së planeve dhe marrëveshjeve,
- k. Miratimit të Planit të Përgjithshëm Strategjik,
- l. Planit të Zhvillimit Ekonomik të Komunës,
- m. Planit Rregullues Urban të Komunës dhe ndryshimit të tyre,
- n. Themelimit të ndërmarrjeve komunale.

23.8 Kjo listë e cekur sipas nenit 23 par.23 .7, nuk mund të ndryshohet përderisa si të tilla janë të parapara edhe me Ligjin që rregullon qeverisjen lokale (Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 17).

23.9 Të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me dhënien e tokës me qira, duhet t'i referohen nenit 14, të

Neni 24

KUVENDI I KOMUNËS

- 24.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë i komunës dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.
- 24.2 Të gjithë qytetarët e komunës mund të kandidojnë në Kuvendin e Komunës, me kusht që ata t'i plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale.
- 24.3 Mandati i çdo anëtar i Kuvendit të Komunës verifikohet nga Komisioni për verifikimin e mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës, para nënshkrimit të mandatit nga secili këshilltar.
- 24.4 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të nënshkruajnë betimin solemn si vijon:

Unë _____, betohem se do t'i kryej detyrat me nder, me besnikëri, pa anime, me ndërgjegje dhe sipas ligjit, dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

- 24.5 Anëtarët e Kuvendit të Komunës, të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni, brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtarë.
- 24.6 Anëtarët e Kuvendit të Komunës mandatin e marrin nga qytetarët që e kanë votuar në zgjedhjet e fundit, por ai gjithashtu duhet t'i kryejë edhe disa procedura formale dhe ligjore.
- 24.7 Kryesuesi i Kuvendit komunal ka të drejtë që t'i lejojë me arsye anëtarëve të Kuvendit që mungojnë në seanca të Kuvendit dhe komiteteve, për një kohë të arsyeshme dhe të lejuar sipas ligjit.
- 24.8 Anëtarit do t'i pushojë mandati edhe nëse ai nuk merr pjesë më tepër se tre muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës.
- 24.9 E gjithë procedura për mandatin apo për marrjen e mandatit për të qenë anëtar i Kuvendit të Komunës në Malishevë, duhet të jetë në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës.

Neni 25

MBLEDHJA INAUGURUESE

- 25.1 Kuvendi i Komunës e mban mbledhjen inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
- 25.2 Mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga Kryetari i zgjedhur, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.
- 25.3 Nëse Kryesuesi i Kuvendit të Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës mund të thirret nga anëtar i më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur Kryetari është dashur të thërrasë mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.
- 25.4 Nëse anëtar i më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të

këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës;

25.5 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të Kuvendit të Komunës kryesohen nga anëtari më i moshuar i Kuvendit të Komunës që është i pranishëm në mbledhje.

Neni 26 KUORUMI

26.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit anëtarëve të kuvendeve komunale.

26.2 Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.

Neni 27 KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

27.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, zgjidhet me vota të fshehta nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe mandati i tij zgjat sa edhe mandati i anëtarëve të Kuvendit;

27.2 Kuvendi i Komunës zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

27.3 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

27.4 Mbledhjet mund të thirren edhe nga çereku i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe Komitetet e Kuvendit të Komunës, në bazë të rregullave dhe procedurave të parapara me Ligj.

27.5 Mbledhjet duhet të thirren në pajtim me këtë Statut dhe Rregulloren e Punës, duke iu përmbajtur këtyrekushteve:

- a) Shpallja duhet të bëhet në tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës 7 (shtatë) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes,
- b) Gjithashtu ajo duhet të vendoset në vendet e frekuentuara brenda territorit të Komunës,
- c) Të njoftohen të gjithë qytetarët përmes mediave elektronike lokale,
- ç) Ueb-faqen e Komunës së Malishevës

27.7 Ndërsa ftesa për mbajtjen e mbledhjes, e cila iu drejtohet këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, duhet të përmbajesë paku këto elemente;

- d) datën e mbajtjes së mbledhjes,
- e) kohën e mbajtjes së mbledhjes,
- f) vendin e mbajtjes së mbledhjes,
- g) rendin e ditës,

ç) materialet e nevojshme për mbledhje.

28.8 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, do të mbahet procesverbali. Ai duhet të përfshijë: emrat e anëtarëve të ftuar dhe atyre të pranishëm, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, propozimet e bëra për miratim, rezultatin numerik të votimit, si dhe përshkrimin e vendimit për miratimin e propozimit apo mos aprovimin e tij. Nëse kërkohet nga këshilltarët mund të specifikohet për secilin se si ka votuar.

29.9 Procesverbalin e mban një shërbyes civil, i caktuar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ndërsaprocesverbalin duhet ta nënshkruajë kryesuesi i asaj mbledhje.

29.10 Kuvendi i Komunës gjithashtu mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme nëse janë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 28
KONFLIKTI I INTERESAVE TË ANËTARËVE TË KUVENDIT KOMUNAL

- 28.1 Anëtar i Kuvendit të Komunës apo anëtar i ndonjërit prej komiteteve, nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjene vendimeve, si dhe pjesëmarrës në procedurat administrative në çështjet që kanë të bëjnë me çfarëdo interesi që ka lidhje me atë, apo ndonjë të afërm të anëtarit të familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.
- 28.2 Secili anëtar i Kuvendit apo ndonjërit nga komitetet, duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që mund të qojnë deri te konflikti i interesit. Secili anëtarë duhet të ofrojë informacione në lidhje me atë se mund të ketë indikacione se pjesëmarrja e kolegut në votim mund të paraqesë konflikt të interesit material apo personal sipas ligjit për zyrtarët publik.
- 28.3 Secili anëtar duhet që vullnetarisht të tërhiqet nga marrja e vendimeve që mund të bjerë ndesh me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.
- 28.4 Anëtarët e Kuvendit të Komunës nuk mund të punësohen në asnjë vend brenda administratës në Kuvendin e Komunës, nëse paraprakisht nuk ka hequr dorë, nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës.
- 28.5 Anëtarët e Kuvendit të Komunës që në mbledhjen e parë inauguruese, duhet të paraqesin një deklaratë të plotë dhe të hapur, në të cilën duhet t'i paraqesin interesat e tyre financiare dhe të njëjtën t'i paraqesin udhëheqësit të personelit, i cili duhet të kujdeset për mirëmbajtjen dhe sigurimin e tyre.
- 28.6 Anëtarët duhet të paraqesin në çdo kohë, çdo ndryshim të tyre në aspektin e ndërrimit të gjendjes financiare, që e kanë paraqitur në fillim.

Neni 29
KOMPETENCAT PLOTËSUESE TË ANËTARËVE TË
KUVENDIT TË KOMUNËS

29.1 Anëtar i Kuvendit të Komunës ka të drejtë:

- a). Të kërkojë sqarime shtesë nga Kryetari, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, apo të ndonjë komiteti, në lidhje me çështjet që janë për diskutim apo që bien në kompetencë të Kuvendit;
- b). Varësisht kujt i është drejtuar kërkesa për sqarime, ai është i obliguar që brenda afatit prej 15 ditësh të kërkojë edhe përgjigjen në lidhje me kërkesën e bërë;
- c). Një kopje e kërkesës së bashku me sqarimin duhet të dorëzohet tek udhëheqësi i administratës dhe personelit, i cili duhet të shënojë në protokoll, datën e pranimi të kërkesës dhe datën e sqarimit të dhënë;
- ç). T'i dorëzojë propozimin me shkrim dhe njëherit t'i bashkëngjisë procesverbalit;
- d). Anëtar i Kuvendit të Komunës, mund të diskutojë edhe në komitete tjera edhe pse nuk është anëtar i tij, por ai nuk ka të drejtë vote;
- e). Ai mund t'i propozojë për diskutim ndonjë propozim komitetit që është përgjegjës për diskutimin e atyre çështjeve.

Neni 30
MANDATI

30.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është katër vjet.

30.2 Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar:

- h) Me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- i) Nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- j) Nëse anëtari ia paraqet kryetarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;
- k) Nëse anëtari është dënuar me aktgjykim të veprës penale të formës së prerë për gjashtë(6) ose më shumë muaj;
- l) Nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht, në mbledhjet e Kuvendit të Komunës pa arsye;
- m) Anëtari i Kuvendit të Komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- n) Nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm e skualifikon apo e konsideron të papërzgjedhshëm.

Neni 31 KOMPENSIMI

31.1 Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligjin që e rregullon këtë lëmi, do të marrë vendim për kompensimin e këshilltarëve të Kuvendit, duke përfshirë edhe pozitën e kryesuesit, si dhe për anëtarët që janë të përfaqësuar nëpër komitete, nëse një gjë e tillë nuk është e përcaktuar paraprakisht me Ligj, apo ndonjë Udhëzim Administrativ nga MAPL-ja nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 32 KOMITETET

32.1 Kuvendi i Komunës së Malishevës, në pajtim me Ligjin në fuqi në Kosovë, do të formojë dy komitetet e obligueshme, të cilat kanë mandat të përhershëm sa ka edhe Kuvendi i Komunës, e të cilat janë:

- a) Komitetin për Politikë dhe Financa.
- b) Komitetin për Komunitete.

32.2 Kuvendi i Komunës mund të formojë edhe komitete tjera që do të merren me shqyrtimin e çështjeve konkrete që kanë një rëndësi jetike për Komunën.

32.3 Gjatë emërimit të anëtarëve nëpër komitete, Kuvendi duhet të sigurojë barazinë gjinore, si dhe në komitetet e përshkruara sipas Ligjit për Qeverisjen Lokale në Kosovë, duhet të përfshijë edhe .proporcionin e komunitetit pakicë, që në këtë Komitet (për komunitete) duhet të ketë shumicën e anëtarëve të këtij komiteti. Me rastin e themelimit edhe të komiteve tjera të parapara sipas Ligjit të lartpërmendur, Kuvendi mund të emërojë edhe anëtarë që nuk janë pjesë e Kuvendit të Komunës, por shumica e anëtarëve të atij komiteti duhet të jetë pjesë e tij.

32.4 Përfaqësimi në komitetet e themeluara nga Kuvendi i Komunës, duhet të përfshijë në mënyrë sa më proporcionale përfaqësimin e partive politike në Kuvend.

32.5 Në Komitetin për Komunitete dhe komitetet tjera kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin i cakton vetë komiteti.

32.6 Kompetencat dhe përbërjen e komiteve që nuk e kanë të përshkruar kompetencën dhe përshkrimin e detyrave me këtë statut, do ta bëjë Kuvendi i Komunës me vendim. Të gjitha komitetet në mbledhjen e parë të çdo viti, do të përcaktojnë kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjeve tjera.

Neni 33 KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

17

- 33.1 Komitetin për Politikë dhe Financa themelohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me ligjin. Anëtarët e këtij komiteti emërohen nga radha e anëtarëve të Kuvendit, ndërsa për numrin e anëtarëve vendos Kuvendi sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Udhëzimit administrativ përkatës.
- 33.2 Në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, mund të marrin pjesë edhe anëtarë tjerë të Kuvendit dhe komiteteve të tjera, me lejen e kryesuesit të diktojnë çështje të caktuara por nuk kanë të drejtë vote në momentin e votimit.
- 33.3 Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa është Kryesuesi i Kuvendit, e në mungesë të tij atë do ta kryesojë njëri nga anëtarët e këtij komiteti me marrëveshje, që njëherësh edhe vendosin për çështjet që duhet të shqyrtohen në mbledhje.
- 33.4 Kryesuesi në këtë komitet, ka të drejtën e votës vendimtare shtesë nëse ka numër të barabartë të votave për dhe kundër ndonjë propozimi
- 33.5 Kompetencat e këtij Komiteti janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë.

Neni 34

KOMITETI I KOMUNITETEVE

- 34.1 Komiteti i Komuniteteve emërohet nga Kuvendi i Komunës dhe atë duke u mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës. Në përbërjen e tij përveç anëtarëve të Kuvendit të Komunës, mund të përfshihen edhe përfaqësues të komuniteteve që nuk janë të përfshirë në Kuvend, por që janë banorë të Komunës së Malishevës.
- 34.2 Komiteti i Komuniteteve do të promovojë të drejtat e komuniteteve, si dhe do t'i mbrojë interesat e tyre në pajtim me ligjet në fuqi në Kosovë.
- 34.2 Në rast se ky komitet gjen shkelje të drejtave të komuniteteve, ai do ta paraqesë përmes kryesuesit të tij këtë gjendje në Kuvendin e Komunës, përmes të cilit do të kërkojë që të merren masa nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
- 34.3 Gjatë themelimit të Komitetit të Komuniteteve, Kuvendi i Komunës duhet të sigurojë se është zbatuar procedura për emërimin e anëtarëve të këtyre komiteteve në përputhje me dispozitat e nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Komunave në Republikën e Kosovës.
- 34.4 Komiteti i Komuniteteve ka për detyrë që, në kuadër të kompetencave të veta, të sigurojë se:
- 34.5 Asnjë person, i cili merr përsipër detyrat publike ose mban post publik, nuk guxon të bëjë diskriminim ndaj asnjë individi pa dallim, në kurrfarë baze për shkak të përkatësisë etnike, gjuhësore lidhjes me komunitetin, si rastet tjera të cilat janë të konsideruara si diskriminuese dhe njëherësh janë edhe të ndaluara sipas Ligjit Kundër Diskriminimit në Kosovë.
- 34.6 Të gjithë banorët gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat civile, politike dhe ekonomike, shoqërore, kulturore dhe mundësi të barabarta punësimi, si dhe qasje të barabartë në shërbimet komunale në përgjithësi.
- 34.7 Shërbimi Civil i Komunës, pasqyron në mënyrë të drejtë numrin e përfaqësuesve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet.

Neni 35

KOMITETET TJERA TË FORMUARA NGA KUVENDI I KOMUNËS

- 35.1 Kuvendi i Komunës në pajtim me ligjet në fuqi në Kosovë, mund të formojë edhe komitete të tjera, të cilat janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punëve dhe detyrave të punës në Kuvend, si:
- a) Komiteti për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe për Persona me Aftësi të Kufizuara;
 - b) Familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftës;
 - c) Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;

- ç) Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm;
- d) Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- dh) Komiteti për Bujqësi;
- e) Komiteti për Shërbime Publike;
- ë) Komiteti për Barazi Gjinore;
- i) Komiteti për Diasporë.

35.2 Kuvendi i Komunës, në kuadër të përgjegjësiive të dhëna me ligj, mund të vendosë edhe për përbërjen dhe numrin e anëtarëve të këtyre komiteteve, nëse nuk është e paraparë ndryshe me Ligj, por edhe vetë komiteti mund të hartojë Rregulloren e punës dhe Planin e veprimit, të cilin duhet ta miratojë Kuvendi.

35.3 Kuvendi mund të kërkojë nga shoqëria civile, grupet e interesit jopolitik që të formojnë edhe komitete këshillëdhënëse dhe konsultative, të cilat do ta ndihmonin Komunën në kryerjen e detyrave të parapara sipas ligjit.

Neni 36 KRYETARI I KOMUNËS

36.1 Kryetari i Komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët e Komunës së Malishevës, me të drejtë vote në përputhje të plotë me procedurat ligjore për zgjedhjen e kryetarëve të komunave në Republikën e Kosovës

36.2 Kryetari i Komunës zgjidhet me mandat të njëjtë me këshilltarët e Kuvendit të Komunës.

36.3 Kur përkohësisht mungon Kryetari i Komunës ose kur përkohësisht nuk ka mundësi të ushtrojë funksionin e Kryetarit, ai autorizon nënkryetarin që përkohësisht ta ushtrojë funksionin e kryetarit.

36.4 Forma dhe teksti i bërjes së betimit nga Kryetari i Komunës:

“ Unë _____, betohem që do t’i kryej detyrat e mia dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i Komunës së Malishevës me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”.

36.5 Kryetari i Komunës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, është përgjegjës dhe ai:

- a. përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
- b. udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe Administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të Komunës;
- c. ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij;
- d. ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- e. emëron apo shkarkon zëvendësit e tij / saj;
- f. emëron dhe shkarkon anëtarët e tij, të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- g. organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
- h. propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
- i. propozon zhvillimin e Komunës, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- j. raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendii Komunës;
- k. mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve;

l. do të konsultojë nënkryetarin për Komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo-shumicë, si dhe
m. aktivitetet tjera që i caktohen me Statut.

- 36.6 Mandati i Kryetarit të Komunës mund të përfundojë vetëm sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Zgjedhjet Komunale. Në rast se Kryetari nuk është në gjendje të ushtrojë detyrat e veta të përcaktuar me ligj, për arsye të ndryshme, duhet të organizohen pa vonesë zgjedhjet e jashtëzakonshme për konstituimin e organeve të reja të Komunës.
- 36.7 Kryetari i Komunës duhet të përjashtohet nga procedurat lidhur me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje, në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i familjes së tij ka interes personal apo financiar.
- 36.8 Kryetari mund të përjashtojë veten vullnetarisht nga pjesëmarrja në ndonjë vendim, për të mos rënë në konfliktinteresi, mirëpo këtë mund ta kërkojë edhe pala e tretë.

Neni 37

NËNKRYETARI I KOMUNËS (zv.kryetar)

- 37.1 Kryetari i Komunës së Malishevës ka të drejtë të emërojë një nënkryetar,
- 37.2 Nënkyetari emërohet nga Kryetari i Komunës për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari,
- 37.3 Nënkyetari vepron sipas urdhrave të Kryetarit të Komunës, i ndihmon atij/asaj në ushtrimin e funksioneve
- 37.4 Kur posti i nënkryetarit lirohet, Kryetari emëron një nënkryetar të ri, por jo më vonë se në afatin prej 30 ditësh pas paraqitjes së postit të lirë. Sa i përket konfliktit të interesit të nënkryetarit, zbatohen në mënyrë të njëjtë rregullat që vlejné për kryetarin e Komunës në rast të konfliktit të interesit.

Neni 38

PROPOZIMI PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT

- 38.1 Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen inauguruese propozon kryesuesin, i cili duhet të zgjidhet me shumicë të thjeshtë votash nga përbërja e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.
- 38.2 Propozimin për emrat e këshilltarëve për kryesues, e kanë grupet parlamentare, por edhe secili anëtar i Kuvendit të Komunës.
- 38.3 Kandidaturat me shkrim i propozohen udhëheqësit të punës së Kuvendit të Komunës, i cili pas shpalljes së renditë ditës, prezanton gojarisht në mbledhje emrat të cilët janë propozuar për pozitën e kryesuesit.

Neni 39

PËRGJEGJËSITË E KRYESUESIT

- 39.1 Kryesuesi do t'i ketë të gjitha ato përgjegjësi që i ka dhënë Ligji për Vetëqeverisjen e Komunave në Republikën e Kosovës si dhe Ligjet tjera që e rregullojnë këtë lëmi.
- 39.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës, dhe punon në pajtim me Ligjin, Statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Në mungesë të kryesuesit, Rregullorja e Punës rregullonse kush thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.
- 39.3 Kryesuesi shkarkohet nga kjo pozitë me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
- 39.4 Procedurat për të realizuar shkarkimin e kryesuesit udhëhiqen nga anëtari më i vjetër i Kuvendit sikur në rastin e emërimit të tij, dhe atë sipas kërkesës të këshilltarëve të Kuvendit, por shkarkimi do të jetë i plotfuqishëm vetëm nëse "për" shkarkim votojnë shumica e thjeshtë e anëtarëve të

39.5 pranishëm
Kërkesën për shkarkim mund ta bëjë edhe vetë Kryetari i Komunës.

Neni 40 DREJTORITË E KOMUNËS

- 40.1 Drejtoritë komunale menaxhohen nga drejtorët e drejtorive, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kryetari i Komunës.
- 40.2 Në pajtim me LVL-në, organizimi i drejtorive komunale bëhet në këto drejtori:
1. Drejtoria për Administratë
 2. Drejtoria për Arsim dhe Edukim
 3. Drejtoria për Shëndetësi
 4. Drejtoria për Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale
 5. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
 6. Drejtoria për Planifikim, Mjedis dhe Urbanizëm
 7. Drejtoria për Bujqësi
 8. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
 9. Drejtoria për Inspektorat
 10. Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë
 11. Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Diasporë
 12. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
 13. Drejtoria për Infrastrukturë.
- 40.3 Pavarësisht paragrafit 40.2, Kryetari i Komunës ka të drejtë të ndryshojë emërtimet dhe numrin e drejtorive, jo më pak se 10 dhe jo më shumë se 13 drejtori
- 40.4 Përveç drejtorive komunale, komuna i ka këto njësi dhe sektorë:
1. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
 2. Njësia e Prokurimit
 3. Njësia e Auditimit të Brendshëm
 4. Sektori Ligjor
 5. Sektori për Komunitete dhe Kthim
 6. Sektori për Informim Publik
 7. Sektori për Integrime Evropiane
 8. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
- 40.5 Të gjithë zyrtarët e lartë në Shërbimin Civil të Komunës, duke përjashtuar drejtorët e drejtorive, pranohen, menaxhohen dhe largohen nga vendi i tyre i punës në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil në Kosovë.
- 40.6 Secili Drejtor i drejtorive komunale përjashtohet nga procedurat lidhur me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje, në të cilën ai apo ajo, apo ndonjëri nga anëtarët e familjes së tij kanë ndonjë interes personal apo financiar.
- 40.7 Në rast se konstatohet se ndonjëri nga drejtorët e drejtorive komunale ka konflikt interesi, Kryetari do të caktojë rolin e tij në lidhje me çështjen e caktuar, do të vendosë vet ai në lidhje me atë çështje apo do të caktojë një drejtor vjetër, i cili nuk ka konflikt interesi.
- 40.8 Përjashtimin e drejtorit nga procedura në marrjen e ndonjë vendimi mund ta kërkojë edhe pala e tretë e cila ka konstatuar se pjesëmarrja e drejtorit të caktuar në procedurë mund të shkaktojë konflikt interesi.

40.9 Për të realizuar këtë të drejtë pala e tretë duhet të kërkojë nga Kryetari i Komunës që ai të ndërmarrë atë veprim, mirëpo gjithmonë me kërkesën e bazuar në ligj.

40.10 Si Drejtor i drejtorive komunale, secili drejtor ka për detyrë:

1. Raporton rregullisht te Kryetari për çështjet që janë e drejtë dhe obligim i tij,
2. Ndhmon Kryetarin, Kuvendin e Komunës dhe Komitetet e tij, duke iu ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.
3. Zbaton të gjitha vendimet e Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës, si dhe zbaton të gjitha detyrat që me ligj i janë lënë në kompetencë Kuvendit të Komunës.
4. Përgatit programin e punës dhe prezanton raportet periodike të punës për drejtorin e tij.
5. Është përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e përditshëm të punës së drejtorisë.
6. Përgatit dhe prezanton planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjelljen e këtyre planeve.
7. Përgjigjet në mënyrë efektive për çfarëdo ankese lidhur me sferën e vet të përgjegjësisë.
8. Merr pjesë dhe kontribuon në punën e Kuvendit të Komunës, të komiteteve të tij dhe në punën e drejtorisë.
9. Përmbush të gjitha detyrat dhe urdhëresat që u caktohen në mënyrë adekuate.

Neni 41

SHËRBIMI CIVIL I KOMUNËS

41.1 Shërbimi civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, përveç:

1. Kryetarit, nënkryetarit dhe drejtorëve komunalë
2. Kryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 42

MENAXHIMI FINANCIAR I KOMUNËS

(BUXHETI I KOMUNËS)

42.1 Për të përmbushur të drejtat dhe detyrimet që dalin sipas ligjit dhe me këtë Statut, Komuna e Malishevës duhet të ketë buxhetin e saj.

42.2 Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë profesionale dhe transparente, dhe i ndërtuar mbi kritere objektive.

42.3 Buxheti i Komunës duhet të përmbajë planin për aktivitetet dhe udhëheqjet ekonomike brenda vitit fiskal, duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të Komunës.

42.4 Ai, gjithashtu, duhet të ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës së Malishevës.

42.5 Buxheti i Komunës, në pajtim me ligjin, miratohet për një vit fiskal, i cili fillon me 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtë vit.

Neni 43

BURIMET FINANCIARE KOMUNALE

43.1 Burimet financiare të një komune përbëhen nga:

- a) të hyrat vetanake të Komunës të përcaktuara në Nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal,
- b) grantet operative,

- c) grantet eventuale të jashtëzakonshme,
- d) të hyrat nga huamarrjet eventuale të Komunës, si dhe të hyra të tjera të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës.

43.2 Të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar nga Komuna në bazë të autorizimit të një ligji nga burimet në vijim, janë të hyra vetanake të Komunës të cilat mund të jenë:

1. taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga Komuna si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuara në bazë të këtij ligji;
2. qiratë në pronat e paluajtshme, të cilat ndodhen në Komunë dhe të cilat janë nënadministrimin ose në pronësi të Komunës;
3. të hyrat nga shitja e pasurive të Komunës;
4. të hyrat nga ndërmarrjet, të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të Komunës;
5. bashkë pagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të cilat ofrohen nga Komuna;
6. të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e Komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;
7. interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;
8. grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare si dhe institucionet ndërkombëtare
9. taksa për lejen e shërbimeve profesionale;
10. Taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë
11. Taksat e lejeve për ndërtimin dhe rrënimin e ndërtesave dhe strukturave tjera
12. Taksa për automjete motorike
13. të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave, të cilat janë përcaktuar si të hyra vetanake komunale në bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.

Neni 44 TË HYRAT NGA DONATORËT

- 44.1 Donatorët mund të derdhin mjetet e tyre financiare që kanë për destinim ndihmën për të zhvilluar Komunën, apo qytetarët e organizuar të saj.
- 44.2 Nëse donatorët derdhin mjete në buxhetin e Komunës me destinim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për destinime të tjera.
- 44.3 Dhuruesi i donacionit, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtë të informohet për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i ka destinuar Komunës së Malishevës në emër të donacionit.

Neni 45 MENAXHIMI ME TË HYRAT VETANAKE

- 45.1 Komuna ka të drejtë të disponojë dhe menaxhojë në mënyrë ta pavarur me të hyrat vetanake
- 45.2 Për përdorimin e mjeteve nga të hyrat vetanake, Kuvendi i Komunës vendos me vendim se në cilat destinime dotë përdoren ato, por gjithmonë duke u mbështetur në ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Neni 46 RAPORTI VJETOR

- 46.1 Kuvendi i Komunës miraton raportin vjetor të Kryetarit të Komunës në bazë të propozimit të bërë nga Komiteti për Politikë dhe Financa, më së largu deri më 31 maj të vitit vijues.

Raporti i cekur sipas nenit 47 duhet të përmbajë:

1. Të hyrat dhe të dalat e planifikuara,
2. Realizimet, synimet e planifikuara me buxhet dhe shkallët e realizimit të tyre,
3. Mënyrën dhe lartësinë e financimeve të aktiviteteve të caktuara,
4. Gjendjen financiare në fund të vitit fiskal,
5. Raportin e kontrollit financiar,
6. Përkrahjen e dhënë për organizatat jofitimprurëse,
7. Marrëveshjet e bëra me fshatrat, lagjet urbane dhe vendbanime tjera,
8. Si dhe të dhëna të tjera, të cilat kërkohen sipas Ligjit dhe akteve tjera nënligjore.

Neni 47

BUXHETI I NDËRMARRJEVE KOMUNALE

- 47.1 Komuna e miraton buxhetin e ndërmarrjeve komunale që kryejnë shërbime për Komunën dhe qytetarët e saj. Buxheti i propozuar nga ndërmarrjet komunale, duhet të përfshijë lartësinë e tarifës së propozuar për shërbimet që i kryen ajo ndërmarrje dhe të dhëna tjera plotësuese të kërkuara sipas ligjit që rregullon këtë lëmi.
- 47.2 Propozimi i buxhetit duhet së pari të dorëzohet në Komitetin për Politikë dhe Financa, i cili do ta shqyrtojë formën e tij si tërësi, dhe pas shqyrtimit i rekomandon Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin përfundimtar.
- 47.3 Komuna ka të drejtë të kontrollojë menaxhimin e buxhetit të ndërmarrjeve komunale, duke kërkuar llogaridhënie, për të gjitha punët dhe detyrat që kompania në fjalë është e obliguar sipas ligjit t'i kryejë në pajtim me zotimet e saj.
- 47.4 Komuna ka të drejtë, gjithashtu, të kërkojë llogaridhënie edhe nga organizatat tjera jofitimprurëse, të cilat ajo i ndihmon me mjete financiare nga buxheti i saj.

Neni 48

ANKESAT DHE MBROJTJA JURIDIKE

- 48.1 Pala mund të parashtrojë ankesë, ose kundërshtime kundër akteve të administratës komunale, nëse ai mendon se me aktin e organit kompetent i është cenuar e drejta si në aspektin procedural, po ashtu edhe në aspektin material.
- 48.2 Ankesa në fjalë duhet të procedohet në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative të Republikës së Kosovës.

Neni 49

PASURIA E KOMUNËS SË MALISHEVËS

- 49.1 Komuna ka të drejtë të posedojë dhe të menaxhojë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.
- 49.2 Komuna ka të drejtë të shesë pasurinë e luajtshme dhe ta japë në shfrytëzim pasurinë e paluajtshme sipas ligjit.
- 49.3 Komuna mban dhe udhëheqë regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e ka në shfrytëzim dhe posedim.

Neni 50

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 50.1 Statuti i Komunës së Malishevës mund të ndryshohet dhe plotësohet, në pajtim me dispozitat e Ligjit

- i cili do të rregullojë këtë lëmi.
- 50.2 Çdo dispozitë e këtij statuti, duhet të jetë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Qeverisjen Lokale dhe ligjet tjera që rregullojnë këtë lëmi dhe në rast të kundërshtimit mes tyre, vlejnë dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 51 HYRJA NË FUQI

- 51.1 Ky Statut hyn në fuqi 7 ditë pas certifikimit të tij nga ana e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
- 51.2 Nga momenti kur ky statut hyn në fuqi, i njëjti shfuqizon të gjitha dispozitat e Statutit të Komunës së Malishevës, i miratuar në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.10.2008.
- 51.3 Nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Statuti, në kohën prej 3 muajve duhet të harmonizohen të gjitha rregulloret, emërtimet e drejtorive dhe aktet tjera me këtë Statut.

Neni 52 INTERPRETIMI

Vetëm Kuvendi i Komunës i Malishevës, ka të drejtë të bëjë interpretimin autentik të këtij Statuti.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi

